

# PARLAMENTI I KROACISË

1459

Në zbatim të nenit 89 të Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, miratoj

## VENDIMIN

### **PËR SHPALLJEN E LIGJIT PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT PËR ARMËT**

Me anë të këtij vendimi, shpall ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit "Për armët", të miratuar nga Parlamenti i Kroacisë në mbledhjen e datës 18 maj 2012.

Kategoria: 011-01/12-01/67

Nr. rendor: 71-05-03/1-12-2

Zagreb, më 22 maj 2012.

Presidenti

i Republikës së Kroacisë

**Ivo Josipović, d.v.**

## LIGJ

### **PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT "PËR ARMËT"**

Neni 1.

Në ligjin "Për armët" ("Fletorja Zyrtare", nr. 63/07. dhe 146/08.), pas nenit 1 shtohet neni 1.a me tekstin e mëposhtëm:

"Neni 1.a

Ky ligj përmban dispozitat në përputhje me aktet vijuese të Bashkimit Evropian:

- Direktiva e Këshillit 91/477/KEE e 18 majit 1991 për kontrollin e blerjeve dhe të mbajtjes së armëve (SL L 256, 3. 9. 1991.),
- Direktiva 2008/51/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 majit 2008 për ndryshimin dhe plotësimin e Direktivës së Këshillit 91/477/KEE për kontrollin e blerjeve dhe mbajtjes së armëve (SL L 179, 8. 7. 2008.)."

Neni 2.

Neni 2. fshihet.

Neni 3.

Në nenin 4, fshihen fjalët: "dhe armët me hark".

#### Neni 4.

Në nenin 5 pika 5), fshihen fjalët: "kur mbahen në vende publike".

Pas pikës 26) shtohet pika e re 27), e cila bëhet:

"7) *Ndërmjetësi i tregtisë e armëve*, që përmendet në këtë ligj është shoqëria tregtare ose profesionisti i autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për kryerjen e aktivitetit të ndërmjetësimit në tregtinë e armëve, nuk është tregtar armësh dhe aktiviteti i tij konsiston në tërësi ose pjesërisht në blerjen, shitjen ose kontraktimin e transferimit të armëve ndërmjet prodhuesit dhe tregtarit të armëve sipas nenit 5 pika 24) e këtij ligji."

Pika e deritanishme 27 bëhet pika 28.

Pika e deritanishme 28), e cila bëhet pika 29), ndryshohet dhe bëhet:

"29) *Tregtia me pakicë e municionit* është shitja e municionit dhe kapsollave ndezëse për municion në mjedise shitjeje të autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Sasia e përgjithshme e barutit në municion nuk duhet të kalojë 20 kg të masës neto të lëndës plasëse, ndërsa sasia maksimale e lejuar e artikujve piroteknikë parashikohet nga rregullorja e posaçme për mjediset e shitjes të artikujve piroteknikë".

Pikat 29-32 bëhen pikat 30-33.

Në pikën 33., e cila bëhet pika 34., pas fjalës: "presion" në vend të pikës vendoset presje dhe shtohen fjalët: "përfshin verifikimet e njëpasnjëshme sipas rendit të mëposhtëm: 1. testimi paraprak, 2. prova e rezistencës së armës, 3. testimi përfundimtar. Testimi i armëve kryhet në përputhje me normat e Komisionit të Përhershëm Ndërkombëtar për Testimin e Armëve të Vogla (në vijim referuar si: C.I.P.).".

Pikat 34.-37 bëhen pikat 35.-38.

#### Neni 5.

Në nenin 6 paragrafi 1 pika 5, fjala: "fishekë" zëvendësohet me fjalën: "predhë".

Në pikën 10, pas fjalës: "armë" në vend të pikës vendoset presje dhe shtohet pika 11 me tekstin e mëposhtëm:

"11. të gjitha llojet e armëve me silenciator, silenciatorët e synuar për armët dhe pjesët e silenciatorëve."

Në paragrafin 2 pika 12, pas fjalës: "armë" në vend të pikës vendoset presje dhe shtohet pika 13 me tekstin e mëposhtëm:

"13 armë me tytë të gjatë që mund të shkrepë një fishek me një tërheqje të këmbëzës dhe me kombinim tytash me vjaska dhe pa vjaska"

Në paragrafin 3 pika 3, pas fjalës: "mortajat" në vend të pikës vendoset presje dhe shtohen pikat 4 dhe 5 me tekstin e mëposhtëm:

"4. armë me ajër me energji kinetike 10,5 J e lart ose shpejtësi predhe 200 m/s e lart dhe kalibër më të madh se 4,5 mm,

5.armë me hark forca e të cilave është më e madhe se 450N."

Në paragrafin 4, pika 1 ndryshohet dhe bëhet:

"1.armë me ajër energjia kinetike e të cilave është më e vogël 10,5 J ose shpejtësia e predhave më e vogël se 200 m/s dhe kalibri maksimal është 4,5 mm,".

Pika 2 ndryshohet dhe bëhet:

"2.armë me hark me fuqi më të vogël se 450 N,".

Neni 6.

Në nenin 7, pika 1 ndryshohet dhe bëhet:

"1.armë e ndaluar – armët dhe municionet e kategorisë A, armët e ftohta të projektuara kryesisht për sulme ose lëndimi ndaj subjekteve të përshtatshëm për shkaktim plagosje kur mbahen në ambiente publike, ndërsa mënyra ose rrethanat e mbajtjes së tyre, tregojnë se mbahen për t'u përdorur për sulm ose plagosje dhe armët e kategorisë C dhe D kur përdoren për ngacmim, sulm ose shkaktim plagosje,"

Në pikën 4. pas fjalëve: "armë të kategorisë D", në vend të pikës vendoset presje dhe shtohen fjalët: "përveç rastit kur kalohet kufiri shtetëror".

Neni 7.

Në nenin 8 pika 2, fjalët: "autorizim për blerje municioni" zëvendësohen me fjalët: "lejekalimi evropiane për armën".

Neni 8

Në nenin 9, pas fjalëve: "Drejtorisë së Policisë" vendoset presje dhe shtohen fjalët: "ose Drejtorisë së Policisë".

Neni 9

Neni 10 paragrafi 2 pika 4 ndryshohet dhe bëhet:

"4) që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje ose nuk është ndjekur penalisht për ndonjë shkelje që tregon se arma mund të keqpërdoret, veçanërisht për shkelje që lidhet me dhunën në familje, dhe që nuk i është komunikuar masa mbrojtëse për dhunë në familje,"

Neni 10.

Ne nenin 11 paragrafi 5, hiqen fjalët: "brenda 15 ditëve nga marrja e vërtetimit".

Pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6 me tekstin e mëposhtëm:

"Organi kompetent informon mjekun e zgjedhur për ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor në lidhje me personat për të cilët është dhënë listë armësh".

Paragrafi i deritanishëm 6 bëhet paragrafi 7.

Neni 11.

Në nenin 12 paragrafi 1 pika 1, pas fjalëve: "Ministria e Punëve të Brendshme" shtohen fjalët: "ose institucionet dhe subjektet e tjera juridike të autorizuara nga Ministria e Punëve të Brendshme për kryerjen e veprimtarisë së trajnimit të qytetarëve për përdorimin e duhur të armëve të zjarrit".

Neni 12.

Në nenin 19 paragrafi 2, hiqen fjalët: "dhe autorizim për blerje municioni".

Neni 13

Nëntitulli poshtë nenit 23 i cili bëhet: "4. *Autorizim për blerje municioni*" dhe neni 23 hiqen.

Neni 14

Në nenin 25 paragrafi 1, fjalët "18 vjet" zëvendësohen me fjalët "21 vjet".

Në paragrafin 3, pas fjalëve: "vërtetimin" vendoset presje dhe shtohen fjalët: "nëse janë krijuar kushtet e nenit 10 paragrafi 2 pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji".

Neni 15.

Në nenin 27, paragrafi 2 ndryshohet dhe bëhet:

"Municioni duhet t'u shitet ose dorëzohet vetëm personave që kanë leje të vlefshme arme".

Neni 16.

Në nenin 29, pas paragrafit 3 shtohet paragrafi 4 me tekstin e mëposhtëm:

"Armët e kategorisë B, C dhe D në ambiente publike nuk duhet t'u ekspozohet qytetarëve të tjerë, as nuk duhet të lëvizin në një mënyrë që shqetëson qytetarët".

Neni 17.

Në nenin 32, paragrafi 3 ndryshohet dhe bëhet:

"Arma e gjuetisë duhet të përdoret vetëm në përputhje me rregulloret për gjuetinë dhe në poligonet civile ose në vende të tjera të caktuara për ushtrime qitjeje".

Neni 18.

Në nenin 34 paragrafi 2, pas fjalëve: "armës së vjetër" shtohen fjalët: "ose shtetasit të huaj që i ka dhënë lidhjes së gjuetarëve të Kroacisë kartën identifikuese të shtetasit të huaj".

Neni 19.

Në nenin 43, pas fjalëve: "pikat 1 - 4 të këtij ligji", shtohen fjalët: "ose nëse i është refuzuar kërkesa për regjistrim arme".

Neni 20.

Në nenin 44 paragrafi 1, pas fjalëve: "të armës së vjetër" vendoset presje dhe shtohen fjalët: "autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit".

Pas paragrafit, 2 shtohen paragrafët 3 dhe 4 me tekstin e mëposhtëm:

"Organi kompetent sekuestron armët e kategorisë C për të cilat është lëshuar një certifikatë në momentin e deklarimit nga personi fizik, i cili nuk i plotëson më kushtet e parashikuara në nenin 10 paragrafi 2 pikat 3, 4 dhe 5 ose kushtet në nenin 10 paragrafi 3 pika 1 të këtij ligji.

Organi kompetent, bashkë me armët e gjuetisë, municionin, autorizimin për blerjen e armës dhe lejen e armës, do të sekuestrojë edhe kartën e gjuetisë".

#### Neni 21.

Në nenin 45 paragrafi 1, pas fjalëve: "do të dërgojë" shtohen fjalët: "me vendimin".

Pas paragrafit 1, shtohet paragrafi i ri 2 me tekstin e mëposhtëm:

"Kontrolli mjekësor sipas paragrafit 1 të këtij neni kryhet në institucionet shëndetësore, shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në mjekësinë e sëmundjeve profesionale dhe te specialistët e mjekësisë së sëmundjeve profesionale që ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë private, që janë ngarkuar për kryerjen e këtyre kontrolleve shëndetësore, pas paraqitjes së dokumentit për kryerjen e kontrollit mjekësor".

Paragrafët e deritanishëm 2-4 bëhen paragrafët 3-5.

Në paragrafin e deritanishëm 5, i cili bëhet paragrafi 6, fjalët: "përmendur në paragrafin 2 të këtij neni" zëvendësohen me fjalët: "përmendur paragrafi 3 të këtij neni".

#### Neni 22

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

"Vendimi për sekuestrimin e armëve, municionit, autorizimit për blerje arme, lejes së armës, autorizimit për koleksionimin e armëve të vjetra, autorizimit për posedim arme dhe autorizimit për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit, miratohet nga organi kompetent.

Për ankesën e paraqitur kundër vendimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, vendos Komisioni i Ankesave, të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kroacisë.

Ankesat kundër vendimit të marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk shtyn zbatimin".

#### Neni 23.

Në nenin 48 paragrafi 1, pas fjalëve: "armëve të vjetra" vendoset presje, ndërsa fjala: "dhe" fshihet dhe pas fjalëve: "autorizim për posedim arme" shtohen fjalët: "dhe autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit".

#### Neni 24.

Në nenin 53 paragrafi 1, pas fjalëve: "armë" shtohen fjalët: "dhe municioni".

Në paragrafin 2, pas fjalëve: "armë" shtohen fjalët: "dhe armët".

Pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3 me tekstin e mëposhtëm:

"Shtetasit kroatë dhe të huaj, për qëllime gjuetie, mund të kalojnë nëpërmjet kufirit deri në tre armë përkatëse, 500 copë municione për armë gjuetie me tytë të pavjaskuar dhe 100 copë municione për armë gjuetie me tytë të vjaskuar, pa mundësi shitje të tyre".

Paragrafi 3 bëhet paragrafi 4.

Neni 25.

Në nenin 54, paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

"Shtetasit kroatë dhe të huaj, kur kalojnë kufirin shtetëror, janë të detyruar t'i deklarojnë armët dhe municionin pranë policisë kufitare dhe në doganë".

Neni 26.

Në nenin 55 paragrafi 9, pas fjalëve: "shitje armësh" shtohen fjalët: "dhe municioni".

Neni 27.

Në nenin 56 paragrafi 3, pas fjalës: "armë" shtohen fjalët: "dhe në dokumentin e identifikimit hidhen të dhënat për hyrjen e armëve dhe të municionit".

Neni 28.

Në nenin 59, paragrafi 3 ndryshohet si më poshtë:

"Nëse armët dhe municioni nuk janë regjistruar në dokumentin identifikues, policia kufitare do të lëshojë autorizim për futjen e armëve në qoftë se shtetasi i huaji disponon autorizim për mbajtjen e tyre sipas rregullave të shtetit në të cilin ka vendbanimin dhe në dokumentin identifikues do të përfshijë të dhënat për futjen e armës dhe të municionit".

Pas paragrafit 3, shtohet paragrafi 4 me tekstin e mëposhtëm:

Gjatë daljes jashtë shtetit, policia kufitare do të sekuestrojë autorizimin për futjen e armëve sipas paragrafit 3 të këtij neni".

Neni 29.

Në nenin 63 paragrafi 2, hiqen fjalët: "i cili ka leje pune ose leje qëndrimi të përhershëm në territorin e Republikës së Kroacisë".

Neni 30.

Në nenin 65, fjalët: "I huaji dhe " zëvendësohet me fjalët: "I huaji ose"

Neni 31.

Në nenin 66, fshihet paragrafi 3.

Neni 32.

Në nenin 69, paragrafi 3 ndryshohet si më poshtë:

"Ministria e Punëve të Brendshme, me vendim, do të anulojë licencën për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të armëve në qoftë se prodhimi i armëve nuk ka filluar brenda një viti pas datës së dhënies së licencës ose nëse kjo veprimtari nuk është zhvilluar për të paktën një vit pas datës në të cilën janë përmbushur kushtet për ushtrimin e kësaj veprimtarie".

Pas paragrafit 3 shtohet paragrafi 4 i cili bëhet:

"Nuk lejohet ankimi kundër vendimit për anulimin e licencës për prodhim armësh, por mund të nisë një debat administrativ".

#### Neni 33.

Në nenin 70 paragrafi 1, pas fjalëve: "të këtij ligji" vendoset presje dhe shtohen fjalët: "përveç kushteve të parashikuara në neni 10 paragrafi 2 pika 6 të këtij ligji".

Pas paragrafit 2, shtohet paragrafi 3 me tekstin e mëposhtëm:

"pavarësisht nenit 10 paragrafi 2 pika 2 të këtij ligji, autorizimi për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit u jepet personave fizikë që kanë mbushur 18 vjeç, nëse janë të kualifikuar për t'u quajtur profesionistë-përdorues arme".

Paragrafi 3 bëhet paragrafi 4.

#### Neni 34

Në nenin 71, paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

"Armët e prodhuara duhet të testohen dhe në pjesët e tyre më të rëndësishme dhe të etiketohen me një etiketë të veçantë që përmban emrin e prodhuesit, emrin e shtetit ku është prodhuar dhe numrin serial. Në qoftë se në numrin serial nuk është paraqitur viti i prodhimit, ai duhet paraqitur veçmas."

Paragrafi 2 fshihet.

Paragrafi 3 bëhet paragrafi 2.

#### Neni 35

Në nenin 72, pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2 i ri me tekstin e mëposhtëm:

" Në ambientet e shitjes mund të shiten edhe artikuj piroteknikë të kategorisë I, II, III, P1 dhe T1, nëse këto ambiente përmbushin kushtet e rregullores së veçantë për njësitë e shitjes së artikujve piroteknikë."

Paragrafët e deritanishëm 2 dhe 3 bëhen paragrafët 3 dhe 4.

#### Neni 36.

Pas nenit 72 shtohet kapitulli X.a dhe neni 72.a me tekstin e mëposhtëm:

### "X.a NDËRMJETËSIMI NË TREGTINË E ARMËVE

#### Neni 72.a

Me ndërmjetësim në tregtinë e armëve mund të merret shoqëria tregtare dhe ndërmjetësit të cilët pajisen me autorizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, përpara regjistrimit në regjistrin gjyqësor ose tregtar.

Dispozitat e nenit 66, 67, 68, 69 paragrafi 1 pika 1 dhe neni 71 i këtij ligji zbatohen rast pas rasti për ndërmjetësimin në tregtinë e armëve.

#### Neni 37.

Në nenin 79, paragrafi 3 ndryshohet si më poshtë:

"Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për terrenet e gjuetisë të regjistruara nga personat juridikë ose shoqëritë për ushtrimin e veprimtarisë së gjuetisë brenda terreneve të gjuetisë, që janë përdorur për kryerjen e qitjeve dhe testimin e armëve të gjuetisë në përputhje me rregulloret e gjuetisë".

Pas paragrafit 3 shtohet paragrafi 4 si më poshtë:

"Për municionet e gjuetisë për zhvillimin e aktiviteteve sportive zbatohen dispozitat e këtij ligji që lidhen me poligonet civile të qitjes".

#### Neni 38.

Në nenin 80, paragrafi 2 ndryshohet si më poshtë:

"Në raste të veçanta, me armë zjarri mund të bëjnë qitje në poligone civile të qitjes persona të moshës deri në 21 vjeç dhe të miturit në qoftë se merren në mënyrë aktive me qitje nën kontrollin e trajnerit i cili plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të nenit 10 të këtij ligji dhe kushtet e parashikuara në dispozitën e veçantë për sportin".

#### Neni 39.

Pas nenit 81, shtohet kapitulli XIII.a dhe neni 81.a me tekstin e mëposhtëm:

"XIII.a AFTËSIMI I QYTETARËVE PËR PËRDORIMIN E DUHUR TË ARMËVE TË ZJARRIT

#### Neni 81.a

Me aftësimin e qytetarëve lidhur me përdorimin e duhur të armës së zjarrit mund të merren institucionet ose subjekte të tjera juridike të cilat, përpara regjistrimit në regjistrin gjyqësor, marrin autorizim nga Ministria e Punëve të Brendshme për kryerjen e veprimtarisë së aftësimit të qytetarëve lidhur me përdorimin e duhur të armës së zjarrit.

Dispozitat e neneve 66, 67, 68, 69, 70 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 71 i këtij neni zbatohen përkatësisht dhe për institucionet dhe subjektet e tjera juridike të cilat aftësojnë qytetarët lidhur me përdorimin e duhur të armëve të zjarrit".

#### Neni 40.

Neni 82 ndryshohet dhe bëhet:

"Qeveria e Republikës së Kroacisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, do të miratojë vendimin me anë të të cilit cakton personin juridik për kryerjen e veprimeve të testimin dhe markimit me vulë të armëve të zjarrit.

Personi i autorizuar juridik mund të fillojë të kryejë veprimet sipas paragrafit 1 të këtij neni mbi bazën e licencës nga Ministria e Punëve të Brendshme, me të cilën konfirmon se personi juridik plotëson kushtet e parashikuara.

Kontrollin e punës së personave juridikë të autorizuar për testimin dhe markimin me vulë të armëve të zjarrit e kryen ministria përgjegjëse për punët e brendshme".

#### Neni 41.



Neni 83 ndryshohet si më poshtë:

"Arma e zjarrit e prodhuar në territorin e Republikës së Kroacisë, përpara se të vendoset në treg i nënshtrohet testimi dhe markimit me vulë ose vendosjes së ndonjë markimi tjetër të identifikueshme sipas rregullit (në vijim referuar si: markimi).

Testimit dhe markimit me vulë, përpara vendosjes në treg, i nënshtrohet edhe arma e zjarrit një pjesë kryesore e të cilës është zëvendësuar ose modifikuar nëpërmjet riparimit.

Dispozitat e këtij ligji që lidhen me testimin dhe markimin me vulë nuk zbatohen për armët e zjarrit:

1. që importohen ose futen nga një shtet tjetër, në qoftë se janë testuar dhe markuar me vulë në atë shtet,
2. importimi i të cilave nga jashtë shtetit kryhet ekskluzivisht për qëllime kërkimore,
3. që transportohen nëpërmjet territorit të Republikës së Kroacisë,
4. që janë të vjetra,
5. të cilat, nga sistemi i Forcave të Armatosura, i policisë dhe organeve të tjera shtetërore dhe subjekteve fizike në pronësi, kalojnë në pronësi të qytetarit, në qoftë se është testuar dhe markuar me vulë,
6. që prodhohen për nevojat e Forcave të Armatosura, policisë dhe organeve të tjera shtetërore, ose eksportohen nga Republika e Kroacisë për këtë qëllim,
7. që prodhohen në Republikën e Kroacisë, eksportohen në vende të cilat pranojnë testimin dhe markimin e armëve në përputhje me dispozitat C.I.P., kur janë testuar dhe markuar në përputhje me dispozitat dhe standardet e vendit në të cilin eksportohet"

Neni 42

Neni 84 ndryshohet si më poshtë:

"Arma e zjarrit sipas nenit 83 paragrafi 3 pikat 1 dhe 5 të këtij ligji i nënshtrohet markimit me vulë, i cili mundëson identifikimin e vitit dhe të shtetit të eksportit, ose të vitit dhe të shtetit që e kalon atë në pronësi të qytetarëve".

Neni 43

Në nenin 85, hiqen paragrafët 2 – 5.

Neni 44.

Neni 86 ndryshohet si më poshtë:

"Shpenzimet e testimi dhe markimit të armës së zjarrit i mbulon prodhuesi ose importuesi i armës".

Neni 45.

Në nenin 88 paragrafi 1 pika 2), përpara fjalëve: "përkohësisht" shtohet fjala: "me vendim".

Në pikën 3), përpara fjalës: "ndalohet" shtohet fjala: "me vendim".

#### Neni 46

Në nenin 89 paragrafit 1, fjalët: "me autorizimet e dhëna për blerje municioni" fshihen, ndërsa fjalët: "për autorizimet e dhëna për posedimin dhe mbajtjen e armëve të gjuetisë ose të armëve sportive gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Kroacisë, autorizimet për transferimin e armëve dhe municionit nëpërmjet territorit të Republikës së Kroacisë, "zëvendësohen me fjalët: "për autorizimet e dhëna për futjen e armëve të gjuetisë dhe të armëve sportive dhe municionit në Republikën e Kroacisë dhe deklarimin e futjes në Republikën e Kroacisë të armëve të kategorisë C, për konfirmimin e futjes së armëve dhe municionit në bazë të autorizimit së lëshuar nga organi kompetent dhe futjes së armëve dhe municionit që mund të blihet pa autorizim".

#### Neni 47.

Në nenin 91 paragrafi 1, pas fjalës: "arma" shtohen fjalët: "ose municioni".

Në paragrafin 2 pika 1, pas fjalës: "blerjen" shtohen fjalët: "sipas këtij ligji", ndërsa fjalët: "(neni 10)," fshihet.

#### Neni 48

Neni 92 ndryshohet si më poshtë:

"Për personat fizikë zbatohet një penaltet nga 3000,00 deri në 15000,00 kuna në rastet e mëposhtme:

- 1) Mjeku i zgjedhur i kujdesit shëndetësor parësor dhe çdo mjek tjetër që nuk njofton menjëherë organin shtetëror për ndryshimin e gjendjes shëndetësore ose për vijimin e mjekimit të pronarit të armës, kur kjo ndikon në aftësinë për të poseduar dhe mbajtur armë (neni 11 paragrafi 6),
- 2) Personat të cilët, në mënyrë të paautorizuar, blejnë, zotërojnë, mbajnë, përpunojnë, shesin, shkëmbejnë ose i transferojnë personave të tjerë municione të cilat janë të ndaluara sipas këtij ligji,
- 3) Nëse nuk i nënshtrohen kontrollit mjekësor çdo pesë vjet (neni 11 paragrafi 3),
- 4) Në qoftë se nuk lejon punonjësin e policisë të përcaktojë që janë kushtet për magazinim dhe ruajtje të sigurt të armatimit (neni 13 paragrafi 4),
- 5) Nëse nuk paraqesin kërkesë për regjistrim të armëve brenda afatit të caktuar (neni 20 paragrafi 1),
- 6) Nëse koleksionon armë të vjetra pa autorizim (neni 24 paragrafi 2),
- 7) Nëse armën e vjetër dhe armën e zotëruar sipas autorizimit për koleksionim armësh të vjetra e përdor si armë; ose nëse blen ose mban municion për këto armë (neni 24 paragrafi 5),
- 8) Nëse armët e përmendura në nenin 24 paragrafi 1 i këtij ligji i shet ose ia dorëzon personave të cilët nuk disponojnë autorizim për koleksionim të armëve të vjetra (neni 24 paragrafi 7),
- 9) Nëse riaktivizon për përdorim armën e çaktivizuar (neni 24 paragrafi 8),
- 10) Nëse u shet ose jep armë dhe municion personave të cilët nuk kanë autorizim të vlefshëm për blerje armësh ose leje arme të vlefshme (neni 27 paragrafi 1),
- 11) Nëse nuk njofton organin kompetent, brenda afatit të parashikuar, për çaktivizimin e përhershëm të armës, për të anuluar dokumentin e armës (neni 27 paragrafi 8),

- 12) Nëse vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 28 paragrafi 2 të këtij ligji,
- 13) Nëse nuk u përmbahet rregullave të publikuara për ndalimin e mbajtjes së armës në ambiente ose hapësira të caktuara (neni 29 paragrafi 1),
- 14) Personi fizik mban armë nën ndikimin e alkoolit, drogës ose mjeteve të tjera stimuluese, ose në atë gjendje që nuk ka mundësi të kuptojë rëndësinë e veprimeve të tij apo t'i kontrollojë ato (neni 29 paragrafi 2),
- 15) Rojet e sigurisë të cilat mbajnë, jashtë orarit të tyre të punës, armë zjarri që i mbajnë gjatë kryerjes së detyrës (neni 29 paragrafi 3),
- 16) Nëse mban armë të kategorisë B, C dhe D në ambiente publike, në një mënyrë që shqetëson qytetarët dhe në vende të dukshme nga qytetarët e tjerë (neni 29 paragrafi 4),
- 17) Nëse mban, armët dhe municionin nuk i ruan në përputhje me nenin 30 të këtij ligji,
- 18) Nëse armët që zotëron në bazë të autorizim për armëmbajtje i mban në kundërshtim me nenin 30 të paragrafit 3 të këtij ligji,
- 19) Nëse nuk e dorëzon armën dhe municionin e tij kur largohet nga vendi i banimit ose i qëndrimit (neni 31 paragrafi 1),
- 20) Në qoftë se përdor armë në kundërshtim me nenin 32 paragrafi 2, 3, 4 dhe 5 i këtij ligji,
- 21) Nëse u jep fëmijëve nën 11 vjeç armë me ajër, hark dhe shigjeta jashtë poligoneve të qitjes ose vendeve të caktuara dhe të rregulluara për ushtrime qitjeje dhe pa mbikëqyrjen e personit profesionist (neni 32 paragrafi 6),
- 22) Nëse armët e gjuetisë dhe armët e gjata sportive transportohen jashtë vendit të gjuetisë ose jashtë poligonit jo të futura në arka apo në valixhe dhe armët e shkurtra të gjuetisë dhe armët e shkurtra sportive nuk transportohen të mbyllura në arka ose në valixhe ose janë të mbushura me municion (neni 32 paragrafi 8),
- 23) Nëse i huazon armët në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 i këtij ligji,
- 24) Nëse ua huazon armët personave të cilët nuk kanë leje arme ose autorizim për blerje arme apo autorizim për koleksionimin e armëve të vjetra (neni 34 paragrafi 2),
- 25) Nëse u huazon të miturve armë me ajër dhe armë me hark (neni 34 paragrafi 4),
- 26) Nëse nuk denoncon humbjen ose vjedhjen e armës ose të municionit (neni 35 paragrafi 1),
- 27) Nëse nuk denoncon armën dhe municionin gjatë kalimit të kufirit shtetëror në doganë (neni 54 paragrafi 1),
- 28) Nëse prodhon municion pa autorizim,
- 29) Nëse blen ose mban municion armësh për të cilat nuk disponon leje arme,
- 30) Nëse përdor armë në proceset e prodhimit, ndërmjetësimin e armëve në qarkullim, në treg, gjatë riparimit ose konvertimit ose gjatë administrimit të poligonit civil pa pasur autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit,
- 31) Nëse prodhon, riparon ose modifikon armë të kategorisë B, C dhe D.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, përveç shkeljeve të parashikuara në pikat 1), 15) dhe 30), vendoset edhe masa mbrojtëse e sekuestrimit të armëve dhe municionit."

#### Neni 49.

Neni 93 ndryshohet si më poshtë:

"Ndaj personave fizikë mund të vendoset një gjobë prej 1000,00 deri në 10 000,00 nëse:

- 1) Nuk e rikthen e papërdorur për blerje arme brenda afatit të caktuar (neni 19 paragrafi 2),
- 2) Nuk deklaron armët e kategorisë C brenda afatit të caktuar (neni 25 paragrafi 2),
- 3) Mban armë pa dokumentet shoqëruese (neni 26),
- 4) Nuk e njofton organin kompetent për shitjen e armës (neni 27 paragrafi 4),
- 5) Nuk e çregjistron armën në afatin e caktuar (neni 27 paragrafi 5),
- 6) Nuk njofton për shitjen e armës dhe municionit në ruajtje (neni 31 paragrafi 2),
- 7) Nuk e mban armën siç duhet ose e përdor atë në mënyrë të shkujdesur ose të pavëmendshme (neni 32 paragrafi 1),
- 8) Mban armët dhe municionin e organizatës së qitjes sportive pa miratimin e kësaj organizate (neni 33 paragrafi 3),
- 9) Nuk njofton brenda afatit të caktuar për ndryshimin e emrit personal ose të vendbanimit (neni 37),
- 10) Nuk njofton organin kompetent për dorëzimin e armës pas vdekjes së pronarit të saj, menjëherë sapo vihet në dijeni të këtij fakti (neni 38. paragrafi 1),
- 11) Vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 53 paragrafi 1 i këtij ligji,
- 12) Kalon përmes kufirit shtetëror, për qëllime gjuetie, më shumë se tre armë gjuetie ose më shumë se 500 pjesë municioni për armë me tytë të pavjaskuar dhe 100 copë municione për armë me tytë të vjaskuar (neni 53 paragrafi 3.),
- 13) Armën dhe municionin që ia shet një shtetasi të huaj nuk e shoqëron deri në kufirin shtetëror t'ia dorëzojë këtij shtetasi nën mbikëqyrjen e policisë kufitare (neni 60 paragrafi 2),
- 14) Ia dorëzon armën një personi që nuk zotëron autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit,
- 15) Nuk mban të dhënat sipas nenit 90 paragrafi 4 të këtij ligji,
- 16) Ruan armë gjuetie - të shtetasve të huaj.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 pikat 2), 3), 6) 7), 10), 11), 12), 13) dhe 16) të këtij neni, vendoset edhe masa mbrojtëse "sekuestrim arme".

#### Neni 50

Neni 94 ndryshon si më poshtë:

"Ndërmjetësi dënohet me gjobë nga 5000,00 deri në 15 000,00 kuna nëse:

- 1) Blen ose mban armë ose municione të cilat janë të ndaluara sipas këtij ligji,
- 2) Blen ose mban pa autorizim armë, për blerjen e të cilave sipas këtij ligji kërkohet autorizim,
- 3) Nuk njofton organin kompetent për shitjen e armëve të kategorisë C brenda tetë ditëve pas shitjes së tyre (neni 25 paragrafi 4),
- 4) Tregtari i autorizuar i armës ia shet ose dorëzon armën dhe municionin personave të cilët, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk mund ta zotërojnë atë (neni 27 paragrafi 1.),
- 5) Nuk për shitjen e armëve dhe municionit brenda afatit të caktuar (neni 27 paragrafi 3),
- 6) Nuk e çregjistron armën brenda afatit të caktuar (neni 27 paragrafi 5),
- 7) Armën që është objekt i regjistrimit të detyrueshëm ia jep për përdorim personave të mitur, jashtë poligoneve sportive ose vendeve të caktuara për ushtrimin e qitjes dhe pa mbikëqyrjen e specialistit (neni 32 paragrafi 6),
- 8) E jep armën për përdorim në kundërshtim me dispozitën e të nenit 33 paragrafi 1 i këtij ligji
- 9) Ia huazon armën personave që nuk disponojnë leje arme, autorizim për blerje arme ose autorizim për koleksionim armësh të vjetra ose personave të huaj të cilëve nuk u është dhënë karta e gjuetisë për të huajt (neni 34 paragrafi 2),
- 10) Nuk njofton për ndryshimin e emrit ose të vendvendosjes brenda afatit të caktuar (neni 37),
- 11) Armën dhe municionin që i shet personit të huaj nuk e dërgon deri në kufirin shtetëror dhe nuk ia dorëzon nën mbikëqyrjen e policisë kufitare (neni 60 paragrafi 2),
- 12) Vendos në treg armë të prodhuara, të cilat nuk janë markuar me vulë ose nuk janë markuar në përputhje me rregulloret për testimin, markimin me vulë dhe etiketimin e armëve të zjarrit të dorës (neni 71 paragrafi 1),
- 13) Kryen tregti të paautorizuar të armëve dhe municioneve (neni 72 paragrafi 1),
- 14) Fillon tregtinë e armëve dhe municioneve përpara se komisioni të përcaktojë se janë kushtet për fillimin e punës (neni 72 paragrafi 2),
- 15) Ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës dhe municionit në treg një personi që disponon kartën për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 72 paragrafi 2),
- 16) Riparon dhe modifikon armët në mënyrë të paautorizuar (neni 73 paragrafi 1),
- 17) Nis aktivitetin e riparimit dhe modifikimit të armëve dhe municionit përpara se komisioni të përcaktojë që janë kushtet për nisjen e punës (neni 73 paragrafi 2),
- 18) Ia beson përdorimin e armëve, gjatë riparimit ose rinovimit, një personi që nuk disponon kartën për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 73 paragrafi 2),
- 19) Armën e riparuar nuk e dorëzon për testim dhe markim me vulë (neni 74 paragrafi 1),
- 20) Pranon për riparim ose rinovim armë të paregjistruara (neni 74 paragrafi 2),

- 21) Nuk njofton për riparimin e armës në afatin e caktuar (neni 74 paragrafi 3),
- 22) Armën e pranuar për riparim ose rinovim e ekspozon në ambiente të caktuara të punës deri në dorëzimin e saj te pronari (neni 75 paragrafi 1),
- 23) Transporton armë pa autorizim ose në kundërshtim me urdhrat e caktuar në licencë (neni 76 dhe 77 paragrafi 2),
- 24) Ngre poligon civil pa autorizim (neni 79 paragrafi 1),
- 25) Ngre poligon civil përpara se komisioni të vendosë që janë kushtet për fillimin e punës (neni 79 paragrafi 2),
- 26) Ia beson përdorimin e armës ose të municionit në poligon civil personit që disponon kartë për përdorim të drejtpërdrejtë të armës së zjarrit (neni 79 paragrafi 2),
- 27) Lejon persona të paautorizuar për të mbajtur armë që të kryejnë qitje në poligon civil (neni 80 paragrafi 1),
- 28) Lejon qitje nga persona të mitur, në kundërshtim me nenin 80 paragrafi 2 i këtij ligji,
- 29) Në qoftë se në mënyrë të pa autorizuar merret me kualifikimin e qytetarit për përdorim të rregullt të armës së zjarrit (neni 81 paragrafi 1),
- 30) Ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës një personi të kualifikuar që nuk është i pajisur me licencë për përdorim të drejtpërdrejtë të armës së zjarrit (neni 81.a paragrafi 2),
- 31) Importuesi që nuk vepron në përputhje me dispozitat e nenit 84 të këtij ligji,
- 32) Nuk mban të dhënat sipas nenit 90 paragrafi 3 të këtij ligji,
- 33) Vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 90 paragrafi 5 të këtij ligji,
- 34) Prodhon armë të kategorisë B, C dhe D pa autorizimi,
- 35) Mban armë gjuetie – shtetasve të huaj,
- 36) Në ambientin ku kryen veprimtari të licencuara sipas këtij ligji, mban armë me qëllim kryerjen e aktiviteteve të palicencuara.

Për shkeljet e parashikuara në paragrafin 1 pikat 1), 2), 4), 5), 7), 8), 9), 11), 12), 13), 14), 16), 18), 19), 20), 23), 24), 25), 26), 27), 28), 29), 30), 31), 34) dhe 35) të këtij neni, vendoset edhe masa e sigurisë "sekuestrim i mallit dhe municionit".

Për shkeljet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, përveç sanksionit me gjobë mund të ndalohet edhe kryerja e aktiviteteve të riparimit dhe rinovimit të armëve, administrimit të poligoneve civile ose aftësisimit të qytetarëve për përdorimin e duhur të armëve të zjarrit".

Neni 51.

Neni 95 ndryshohet si më poshtë:

"Një person juridik gjobitet me 20 000,00 deri në 200 000,00 kuna për shkeljet e mëposhtme:

- 1) Blen ose mban pa autorizim armë, për blerjen e të cilave sipas këtij ligjit kërkohet autorizim,
- 2) Nuk njofton organin kompetent brenda tetë ditëve nga data e shitjes së armës së kategorisë C (neni 25 paragrafi 4),
- 3) Tregtari autorizuar i armëve që shet ose i jep armë personave që sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund t'i ketë (neni 27 paragrafi 1),
- 4) Nuk njofton në afatin e caktuar për shitjen e armës (neni 27 paragrafi 3),
- 5) Nuk e çregjistron armën në afatin e caktuar (neni 27 paragrafi 5),
- 6) Jep armë që janë është objekt i njoftimit të detyrueshëm për përdorim nga persona të mitur ose jashtë poligoneve sportive apo jashtë vendeve të caktuara për ushtrime qitjeje dhe pa mbikëqyrjen e ekspertit (neni 32 paragrafi 6),
- 7) E jep armën për përdorim në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 paragrafi 1 të këtij ligji,
- 8) Ia huazon armën një personi që nuk ka leje arme, autorizim për blerje arme ose autorizim për koleksionim të armëve të vjetra, ose një shtetasi të huaj të cilit nuk i është dhënë kartë gjuetie për të huajt (neni 34 paragrafi 2),
- 9) Nuk njofton në afatin e caktuar ndryshimin e emrit ose të vendndodhjes (neni 37),
- 10) Armën dhe municionin që ia shet një shtetasi të huaj nuk e dërgon deri në kufirin shtetëror dhe nuk ia dorëzon shtetasit të huaj nën mbikëqyrjen e policisë kufitare (neni 60 paragrafi 2),
- 11) Prodhon armë në mënyrë të paautorizuar (neni 66 paragrafi 1),
- 12) Nis prodhimin e armëve përpara se komisioni të përcaktojë nëse janë kushtet për nisjen e punës (neni 69 paragrafi 1),
- 13) Ia beson drejtpërdrejt administrimin e armëve në prodhim një personi që nuk disponon kartën për administrim të drejtpërdrejtë të armës së zjarrit (neni 70 paragrafi 1),
- 14) Ambientet në të cilat mbahen armët e prodhuara nuk janë të siguruara nga hyrja e personave të paautorizuar (neni 70 paragrafi 3),
- 15) Vendos në treg armë të prodhuara të cilat nuk janë markuar me vulë ose në përputhje me rregulloret për testimin, markimin me vulë dhe markime të tjera të armës së zjarrit të dorës (neni 71 paragrafi 1),
- 16) Kryen tregti të paautorizuar të armëve dhe municioneve (neni 72 paragrafi 1),
- 17) Nis tregtinë e armëve dhe municioneve përpara se komisioni të përcaktojë se janë kushtet për fillimin e punës (neni 72 paragrafi 2),
- 18) Ia beson administrimin e drejtpërdrejtë të armës dhe municionit për tregtim një personi që nuk disponon kartën për administrim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 72 paragrafi 2),
- 19) Riparon ose modifikon armë pa autorizim (neni 73 paragrafi 1),
- 20) Nis veprimtarinë e riparimit dhe modifikimit të armëve dhe municionit përpara se komisioni të përcaktojë nëse janë kushtet për fillimin e punës (neni 73 paragrafi 2),

- 21) Ia beson administrimin e drejtpërdrejtë të armës, gjatë riparimit dhe modifikimit, një personi që nuk disponon kartë për administrim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 73 paragrafi 2),
- 22) Armën e modifikuar nuk e dorëzon për testim dhe nuk e markon me vulë (neni 74 paragrafi 1),
- 23) Pranon për riparim ose modifikim armë të peregjistruara (neni 74 paragrafi 2),
- 24) Nuk njofton për riparimin e armëve në afatin e caktuar (neni 74 paragrafi 3),
- 25) Armët që ka pranuar për riparim ose modifikim i ekspozon në ambientet e caktuara për punë deri në dorëzimin e saj pronarit (neni 75 paragrafi 1),
- 26) Transporton armë pa autorizim ose në kundërshtim me urdhëresat e përcaktuara në autorizim (neni 76 dhe neni 77 paragrafi 2),
- 27) Ngre poligon civil në mënyrë të paautorizuar (neni 79 paragrafi 1),
- 28) Ngre poligon civil përpara se komisioni të përcaktojë nëse janë kushtet për nisjen e punës (neni 79 paragrafi 2),
- 29) Ia beson administrimin e armëve ose municionit në poligon civil drejtpërdrejt një personi që nuk disponon kartën për administrim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 79 paragrafi 2),
- 30) Lejon qitje në poligon civil nga një person fizik që nuk është i autorizuar për të mbajtur armë (neni 80 paragrafi 1),
- 31) Lejon qitje nga të miturit, në kundërshtim me dispozitën e nenit 80 paragrafi 2 të këtij ligji,
- 32) Fillon me aftësimin e qytetarit përpara se komisioni të përcaktojë se janë kushtet për fillimin e punës (neni 81.a paragrafi 2),
- 33) Ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës një personi të kualifikuar që nuk është i pajisur me licencë për përdorim të drejtpërdrejtë të armës së zjarrit (neni 81.a paragrafi 2),
- 34) Importuesit që nuk veprojnë siç parashikohet në nenin 84 të këtij ligji,
- 35) Organizatat sportive të qitjes, organizatat e gjuetisë dhe personat e tjerë juridikë, të cilët nuk mbajnë të dhënat sipas nenit 90 paragrafi 1 të këtij ligji,
- 36) Nuk mban të dhënat sipas nenit 90 paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij ligji,
- 37) Vepron në kundërshtim me nenin 90 paragrafi 5 të këtij ligji,
- 38) Personi juridik i cili ruan armët e gjuetarëve – shtetas të huaj,
- 39) Në ambientin në të cilin kryen aktivitet për të cilin është licencuar në bazë të këtij ligji, mban armë për kryerje aktiviteti për të cilin nuk ka marrë licencë.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 pikat 1), 3), 4), 6), 7), 8), 10), 11), 12), 15), 16), 17), 19), 20), 22), 23), 25), 27), 28), 29), 30), 31), 32), 33), 34) dhe 38) të këtij neni, vendoset edhe masa e sigurisë "sekuestrim i armës dhe municionit".

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, i vendoset masa gjobë nga 5000,00 deri në 15 000,00 kuna edhe personit përgjegjës në subjektin juridik.



Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, përveç gjobës mund të vendoset edhe masa e sigurisë "ndalim i kryerjes së aktivitetit të prodhimit, tregtisë, riparimit dhe modifikimit të armëve dhe administrimit të poligonit civil".

#### Neni 52

Neni 96 ndryshohet si më poshtë:

"Për shkeljet e nenit 91 dhe nenit 92 paragrafi 1, përveç shkeljeve të përmendura në pikën 1), 15) dhe 30), nenin 93, paragrafi 1 pikat 1), 4), 5), 8), 9), 14) dhe 15), nenin 94 paragrafi 1 pikat 3), 6), 10), 15), 17), 21), 22), 32), 33) dhe 36) dhe nenin 95 paragrafi 1 pikat 2), 5), 9), 13), 14), 18), 21), 24), 25), 35), 36), 37) dhe 39) të këtij ligji, armët dhe municioni sekuestrohen edhe në rast se pas procedimit të shkeljes, i akuzuari nuk shpallet fajtor, nëse është e nevojshme për interesa publike dhe të sigurisë së përgjithshme.

Gjykata e kundërvajtjeve nga e cila është bërë përmbyllja e procedurës lëshon vendim të posaçëm për sekuestrimin e armëve dhe municionit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Pas mbylljes së procesit përfundimtar mbi kundërvajtjen, të zhvilluar sipas dispozitave të neneve 91, 92, 93, 94 dhe 95 të këtij ligji, armët dhe municioni i sekuestruar i dorëzohet Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Armët dhe municioni të cilat, gjatë kohës së sekuestrimit nga qytetari ose gjatë ruajtjes, përcaktohet se përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe të cilat nuk mund të ruhen në mënyrën e duhur, mund të asgjësohen edhe përpara përmbylljes së procedurës.

Në bazë të kërkesës së detajuar të autoritetit që ka kryer sekuestrimin e përkohshëm të armës ose me të cilën arma dhe municioni i është besuar për ruajtje organit në të cilin zhvillohet procedura, miraton me vendim të posaçëm për sekuestrimin dhe asgjësimin e armëve dhe municionit sipas paragrafit 4 të këtij neni. Në raste të veçanta, në qoftë se bëhet fjalë për armë ose municion, asgjësimi i të cilave nuk pret, asgjësimi mund të kryhet edhe pa vendim të miratuar, duke njoftuar për asgjësimin urgjent dhe shkaqet e tij autoritetin në të cilin zhvillohet procedura".

#### Neni 53.

Në nenin 112, fshihet numri "23".

#### Neni 54

Personat fizikë të cilët disponojnë armë me ajër me energji kinetike 10,5 J e lart ose shpejtësi të predhave 200 m/s e lart dhe me kalibër më të madh se 4,5 mm dhe armë me hark fuqia e goditjes së të cilave është mbi 450 N, të cilat sipas dispozitave të këtij ligji mbahen pa autorizim, janë të detyruar që t'i deklarojnë ato pranë organit kompetent brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për personat fizikë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni vendoset sanksioni gjobë nga 5000,00 deri 15 000,00 kuna nëse nuk deklarojnë armë me ajër me energji kinetike 10,5 J e lart ose shpejtësi të predhe 200 m/s e lart dhe me kalibër mbi 4,5 mm dhe armët me hark fuqia e të cilave është mbi 450 N.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni vendoset edhe masa e sigurisë "sekuestrim arme".

Armët do të sekuestrohen edhe në rastin kur procedimi i kundërvajtjeve përmbyllet me një vendim sipas të cilit i akuzuari shpallet i pafajshëm, nëse është e nevojshme për interesa publike ose të sigurisë së përgjithshme.

Pas përfundimit të procedimit të kundërvajtjes sipas dispozitës së këtij neni, arma e sekuestruar i dorëzohet Ministrisë së Punëve të Brendshme.

#### Neni 55

Personat fizikë të cilët nuk disponojnë vërtetim të aftësitë për të poseduar ose mbajtur armë sipas ligjit "Për armët" ("Fletoret Zyrtare", nr. 69/92, 26/93, 43/93, 29/94, 108/95, 20/97, 27/99, 12/01 dhe 19/02) ose vërtetimi i të cilëve ka skaduar, janë të detyruar t'i dërgojnë organit kompetent, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, një vërtetim të aftësitë për të poseduar dhe mbajtur armë të marrë maksimumi tre muaj përpara.

Personat fizikë të cilët nuk i dërgojnë organit kompetent vërtetimin e aftësisë për posedim dhe mbajtje arme, në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, gjobiten me 3000,00 deri në 15 000,00 kuna.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, vendoset edhe masa e sigurisë "sekuestrim i armëve dhe municionit".

Armët sekuestrohet edhe në rastin kur në përfundim të procedimit të kundërvajtjes i akuzuari shpallet i pafajshëm, nëse është e nevojshme për interesa të sigurisë publike ose të përgjithshme.

Pas përfundimit të procedimit të shkeljeve sipas dispozitave të këtij neni, armët dhe municioni i sekuestruar i dorëzohen Ministrisë së Punëve të Brendshme.

#### Neni 56.

Personat fizikë të cilët kanë armë të regjistruar, kanë detyrimin që të njoftojnë organin kompetent shtetëror për mjekun e zgjedhur të kujdesit shëndetësor parësor brenda 180 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Personat fizikë të cilët kanë armë të regjistruar kanë detyrimin që të njoftojnë organin kompetent mbi ndryshimin e ndodhur, brenda 60 ditësh nga data e ndryshimit të mjekut të zgjedhur të kujdesit shëndetësor parësor.

Personave fizikë të cilët nuk u dërgojnë organeve kompetente të dhëna për mjekun e zgjedhur të kujdesit shëndetësor parësor ose për ndryshimin e tij, në afatet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, u anulohet leja e armës, ndërsa me armën veprohet sipas nenit 44 paragrafi 1. Ligji "Për armët".

#### Neni 57.

Personat fizikë të cilëve u është dhënë autorizim për posedim armësh si suvenir, kanë detyrimin që brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji:

- 1) të çaktivizojnë armën dhe ta mirëmbajnë atë ose
- 2) t'ia dorëzojnë armën Republikës së Kroacisë, kundrejt asnjë kompensimi.

#### Neni 58.

Ministri i punëve të brendshme, brenda tre muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton rregulloren për kushtet e posaçme që duhet të plotësojnë institucionet dhe subjektet e tjera juridike që do të aftësojnë qytetarët për përdorimin e duhur të armëve të zjarrit.

Ministri i punëve të brendshme, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton rregulloren për kushtet e posaçme që duhet të përmbushin institucionet dhe subjektet e tjera juridike që kryejnë testimin dhe markimin me vulë të armës së zjarrit dhe rregullore për testimin dhe markimin me vulë të armës së zjarrit.

#### Neni 59

Në tërësinë e tekstit të ligjit "Për armët" ("Fletorja Zyrtare" nr. 63/07.) fjalët: "licencë për ushtrim aktiviteti ose leje qëndrimi e përkohshme" zëvendësohen me fjalët: "leje qëndrimi e përkohshme ose e përhershme", në trajtën përkatëse, fjalët: "ndërmjetëson" dhe "ndërmjetësim" zëvendësohen me fjalët: "ndërmjetës", ndërsa fjala: "helmuese", në trajtën përkatëse, fshihet.

#### Neni 60.

Dispozitat e nenit 91 paragrafi 1 të ligjit "Për armët" bëhen të pazbatueshme më 1 janar 2013.

#### Neni 61

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit të tij në "Fletoren Zyrtare", përveç dispozitave të nenit 7 dhe 40, të cilat hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Evropian.

Klasa: 213-02/12-01/01

Zagreb, më 18 maj 2012.

### PARLAMENTI I KROACISË

Presidenti

i Parlamentit të Kroacisë

**Boris Šprem, d.v.**